



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 21, DATË 15.02.2019

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË NGJARJEVE ME RËNDËSI TË MADHE PËR
PUBLIKUN SI DHE MËNYRËN E TRANSMETIMIT PA PAGESË TË TYRE NGA
OSHMA-JA E KUALIFIKUAR

Në zbatim të nenit 19 pika 16 dhe nenit 127 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun si dhe mënyrën e transmetimit pa pagesë të tyre nga OSHMA-ja e kualifikuar, sipas Aneksit Nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Piro

MISHA

Suela

MUSTA

Zylyftar

BREGU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

ANEKS NR. 1

**LISTA E NGJARJEVE ME RËNDËSI TË MADHE PËR PUBLIKUN SI DHE
MËNYRA E TRANSMETIMIT PA PAGESË TË TYRE NGA OSHMA-JA E
KUALIFIKUAR**

Neni 1

Ngjarjet me rëndësi të madhe

- 1.1 Ky aneks i referohet transmetimit audioviziv të ngjarjeve të konsideruara me rëndësi të madhe për publikun.
- 1.2 Për qëllime të kësaj liste:
- A. Konsiderohet “*Ngjarje me rëndësi të madhe*”, një ngjarje me rëndësi publike në Shqipëri, ose brenda një territori të tij, me natyrë sportive ose josportive, e cila përbush të paktën dy nga kushtet e mëposhtme:
- për ngjarjen ka një interes të veçantë dhe të përhapur në vend, ku personat e interesuar janë edhe të tjerë, përveç atyre, të cilët zakonisht ndjekin ngjarje të tilla përmes televizionit;
 - ngjarja gëzon njohje të gjerë nga publiku i përgjithshëm, ka një ndikim kulturor të rëndësishëm, forcon identitetin kulturor dhe nuk ka përmbytje partiake;
 - ngjarja përfshin pjesëmarrjen e skuadrës kombëtare të një disipline sportive të veçantë, në një ngjarje ose garë të rëndësishme ndërkombëtare;
 - ngjarja historikisht është transmetuar pa pagesë përmes televizionit dhe ka pasur një shikueshmëri të lartë në vend.
- B. Konsiderohet “*OSHMA e kualifikuar*”, një ose disa OSHMA të licencuar të cilët realizojnë mbulimin e përgjithshëm të një ngjarjeje me rëndësi. Kur dy ose më shumë OSHMA lidhin kontratë ose marrëveshje për të realizuar së bashku mbulimin e përgjithshëm të një ngjarjeje me rëndësi, kemi të bëjmë me një OSHMA të kualifikuar në lidhje me mbulimin e përgjithshëm.
- C. “*Mbulim i përgjithshëm*”, është mbulimi nga një shërbim pa pagesë i transmetimit për të paktën 95 për qind të popullsisë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Lista e ngjarjeve me rëndësi të madhe

- 2.1 AMA përcakton listën e mëposhtme të ngjarjeve që konsiderohen të një rëndësie të madhe për publikun dhe që një OSHMA i kualifikuar në juridiksionin e Republikës së

Shqipërisë duhet t'i transmetojë duke siguruar mbulimin e përgjithshëm si dhe pa pagesë shtesë për publikun:

1. Lojërat Olimpike Verore dhe Dimërore;
2. Finalja dhe të gjitha ndeshjet e ekipit kombëtar në kampionatin botëror të futbollit;
3. Finalja dhe të gjitha ndeshjet e ekipit kombëtar në kampionatin evropian të futbollit;
4. Të gjitha ndeshjet e ekipit kombëtar shqiptar të futbollit brenda vendit dhe jashtë vendit, në të gjitha takimet zyrtare, përfshirë dhe miqësoret zyrtare;
5. Veprimtaritë sportive ndërkombëtare, ku merr pjesë ekipi kombëtar shqiptar i basketbollit dhe volejbollit.
6. Lojërat Mesdhetare ku merr pjesë Shqipëria.
7. Kampionatet Evropiane apo Botërore ku merr pjesë ekipi kombëtar sipas disiplinave të ndryshme sportive.
8. Festivali i Muzikës Shqiptare;
9. Koncerti i Vitit të Ri i Filarmonikës së Vienës;
10. Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës.

2.2 Autoriteti ka të drejtë të amendojë me iniciativën e vet listën e ngjarjeve me rëndësi të madhe dhe kushtet e transmetimit të tyre, duke iu referuar kritereve të përcaktuara.

Neni 3

Kushtet e transmetimit të ngjarjeve me rëndësi të madhe

- 3.1 Ngjarjet e përmendura në pikat 2, 3 dhe 7 të pikës 2.1 të nenit 2, transmetohen drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të plotë. Për ngjarjet e tjera është OSHMA-ja që vendos mënyrën e transmetimit, pra drejtpërdrejt dhe të plotë apo të pjesshme, ose me regjistrim, të plotë apo të pjesshme.
- 3.2 Nëse një OSHMA në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nuk është i kualifikuar, por zotëron të drejtën ekskluzive për të transmetuar një ngjarje të përcaktuar sipas nenit 2 më sipër, ky OSHMA ia vë në dispozicion transmetimin e ngjarjes, OSHMA-së së kualifikuar, kundrejt pagesës së një shume të arsyeshme, mbi bazën e vlerës së tregut, prej këtij të fundit.
- 3.3 Kur një OSHMA i kualifikuar zotëron të drejtën ekskluzive ose të transmetimit të ngjarjes ose në bazë të një kontrate me organizuesin e ngjarjes, OSHMA-ja i kualifikuar duhet të transmetojë ngjarjen në një shërbim pa pagesë, duke siguruar mbulimin e përgjithshëm.
- 3.4 Nëse për arsye të vlerës së çmimit të tregut, kalimi i së drejtës së transmetimit, sipas përcaktimit të pikës 3.2, të këtij neni, nuk mund të realizohet, OSHMA-ja, që zotëron të drejtën ekskluzive të transmetimit të ngjarjes së përcaktuar, i vë në dispozicion OSHMA-së së kualifikuar një përmbledhje të transmetimit të ngjarjes.

Neni 4

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 4.1 Një OSHMA mund të kërkojë nga AMA të zgjidhë mosmarrëveshjet në lidhje me shërbimin pa pagesë të transmetimit brenda vendit për mbulimin e përgjithshëm.
- 4.2 AMA ka të drejtë të këshillohet me ekspertë teknikë ose persona të tjerë të specializuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 5
Ankimi për ngjarjet me rëndësi të madhe

Nëse një OSHMA pretendon se ka ndodhur ose mund të ndodhë mosrespektimi prej një ose disa OSHMA-ve i kërkesave të nenit 3, mund bëjë ankim në gjykatë kundër këtyre OSHMA-ve, duke kërkuar:

- a) anulimin e kontratës së të drejtës ekskluzive të transmetimit;
- b) përcaktimin e dëmeve civile, të shkaktuara nga ofruesit e tjerë;
- c) njohjen e së drejtës për ofrimin e mbulimit të ngjarjes subjektivit të interesuar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga AMA.

Neni 7
Publikimi

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të AMA-s.